

VENDIM
Nr. 526, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TRANSFERIMIN E MBETJEVE JO TË RREZIKSHME DHE INFORMACIONIT QË DUHET TË PËRFSHIHET NË DOKUMENTIN E TRANSFERIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 11, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen e elektronike”, dhe të pikës 11, të nenit 21, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Mbetje jo të rrezikshme klasifikohen mbetjet që nuk shënohen me shenjë yll “*”, të miratuara me vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, të cilit më poshtë i referohemi me emërtimin “Katalogu i mbetjeve”.”.

2. Pikat 13, 14 dhe 15 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“13. Krijuesi, grumbulluesi dhe pritësi i mbetjeve raportojnë në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, informacion lidhur me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara, referuar dokumentit të transferimit, të paktën 1 (një) herë në 6 muaj.

14. Dokumenti i transferimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit pas paraqitjes së kërkesës, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, nga personi që transferon mbetjet jo të rrezikshme tek pritësi. Agjencia Kombëtare e Mjedisit shqyrton kërkesën dhe verifikon të dhënat e kërkuarit nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe licencën III.2.B. Në rast se nga verifikimi konstatohet se dokumentacioni i depozituar nga kërkuari nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit e të pasaktësive të konstatuara brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga dita e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuari njoftohet përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet.

15. Agjencia Kombëtare e Mjedisit miraton pjesën e parë të Kodit Unik brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”.”.

3. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe administron një bazë të dhënash për kodet unike. Baza e të dhënave shërben si pjesë e Regjistrimit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme, që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Baza e të dhënave për kodet unike përmban elementet e mëposhtme:

- a) institucionin administruar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- b) të dhënat parësore, si: lloji i mbetjes, kodi i mbetjes sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, gjendja/forma fizike e mbetjes (e gaztë/e lëngët/e ngurtë/pluhur/llum/përzier);
- c) të dhënat dytësore, si: numri i regjistrimit, NIPT-i, numri i identifikimit të lejes së mjedisit, numri i identifikimit të licencës III.2.B;

ç) dhënësit e informacionit, si personi fizik/juridik, QKB-ja;

d) ndërveprimi QKB–Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

dh) personat e interesuar, si personi fizik/juridik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.”.

4. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, raportimi i informacionit lidhur me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama